



---

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AUTORITETI I KONKURENCËS

## NJOFTIM PËR SHTYP

Në kuadër të promovimit të mëtejshëm të kulturës së konkurrencës, në datën 31.05.2022, në ambientet e Universitetit European të Tiranës, u zhvillua workshop me temë “Promovimi i mëtejshëm i kulturës së konkurrencës me botën akademike” me pjesëmarrjen e Kryetarit të Autoritetit të Konkurrencës, Z. Denar Biba, përfaqësues të AK, profesorë dhe studentë të programit master në fushën e drejtësisë dhe ekonomisë.

Në këtë takim u bë prezantimi i Ligjit Nr. 9121/2003 nga Kryetari i Autoritetit të Konkurrencës, me qëllim sigurimin e njohurive të nevojshme në fushën e ligjit të konkurrencës. Gjithashtu, u prezantua rasti i përqendrimit nëpërmjet përfitimit të kontrollit të shoqërisë Albania Telecom Invest AD nga shoqëria 4iG Nylvanosan Mukodo Reszvenytarsasag në tregun e komunikimeve elektronike, si dhe rasti në tregun e shërbimit të ngarkim-shkarkimit të anijeve kontenierike dhe aktivitetet e lidhura me to në terminalin e kontenierëve Durrës, nga përfaqësues të AK. Gjatë takimit kishte diskutime dhe pyetje të ndryshme nga auditori, të cilat morën përgjigje nga Kryetari z. Biba dhe përfaqësuesit e tjerë të Autoritetit të Konkurrencës.

Këto leksione dhe takime informative/edukuese do të vijojnë të organizohen nga Autoriteti i Konkurrencës jo vetëm në kuadër të rekomandimeve të Rezolutës së Kuvendit të Shqipërisë, “Për vlerësimin e veprimtarisë së Autoritetit të Konkurrencës për vitin 2021”, por edhe si mision që autoriteti i ka vendosur vetes për promovimin e mëtejshëm të kulturës së konkurrencës përmes intensifikimit të marrëdhënieve me botën akademike, strukturat e biznesit dhe institucionet e tjera publike e private për çështjet e rregullimit të tregut, mbarëvajtjes së konkurrencës dhe mirëqënies së konsumatorit.